

VENDIM
Nr. 408, datë 18.6.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 502, DATË 13.7.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES UNIFORME TË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe të ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 3, të nenit 13, të Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 502, datë 13.7.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Autoritetet që miratojnë lejet e punimeve sipas parashikimit të nenit 12, janë të detyruara që, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, teknik e financiar të depozituar nga subjekti aplikues/zhvillues, të verifikojnë pranë furnizuesit të energjisë elektrike pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike për kontratën/kontratat e furnizimit që rezulton/rezultojnë në emër të subjektit aplikues/zhvillues. Në rast se subjekti aplikues/zhvillues është person fizik dhe kontrata/kontratat e furnizimit me energji elektrike është/janë në emër të pjesëtarëve të familjes, autoritetet që miratojnë lejet e punimeve verifikojnë përmbushjen e detyrimeve edhe për pjesëtarët e familjes së tij, sipas certifikatës familjare. Në rast se, pas verifikimit, rezulton se subjekti aplikues/zhvillues nuk ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike, autoritetet që miratojnë lejet e punimeve njoftojnë subjektin dhe pezullojnë miratimin e lejes, deri në përmbushjen e këtij detyrimi.

Pezullimi i miratimit të lejes nuk bëhet kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara nga furnizuesi, janë në proces ankimimi në gjykatë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama